



**Republika e Shqipërisë**  
**Universiteti i Sporteve të Tiranës**  
**Rektorati**

Tiranë, më 21.09.2017

**Njoftim**

**Për aplikimet dhe regjistrimet në ciklin e dytë të studimeve “Master profesional” dhe “Master i shkencave”, me kohë të plotë, në UST.**

Në UST, pranë Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit fillojnë aplikimet për programet e studimit të ciklit të dytë të studimeve, “Master profesional” dhe “Master i shkencave”, me kohë të plotë.

Aplikimet e kandidatëve kryhen pranë sekretarive mësimore të fakulteteve në datat **25 Shtator 2017 deri 20 tetor 2017**, nga ora 8<sup>00</sup> deri 15<sup>00</sup>.

Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij dhe dorëzon në sekretarinë mësimore, dokumentacionin sic është përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 18, dt. 16. 08. 2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 15, datë 19.05.2017 "për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2017 -2018", Kreu VI/4

Tarifa e aplikimit për programet e studimit të ciklit të dytë është **2500 lekë**.

Fleta “Faturë Arketimi”, me të cilën kandidati do të paraqitet në banke për të bërë pagesën e tarifës, mund të shkarkohet nga faqja Web e UST nga vetë kandidati.

Informacion i plotë për aplikimet dhe regjistrimet, për udhëzimin e MAS nr. 18, dt. 16.08.2017, vendimin e Rektorit për aplikimet gjendet në faqen Web të UST dhe pranë sekretarive mesimore.

**Prof. Dr. Agron ÇUKA**

**REKTOR**

